



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN**

PROCESVERBAL

nga mbledhja e V-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 maj 2023 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 11:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Ilmi Azemi, Nurie Halili, Lorik Maxhuni, Agron Perçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia, (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Shpëtim Zhegrova (Nënkyetar i Komunës), drejtori i drejtive, Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore, Haki Maloku nga zyra e kryetarit, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Në mungesë të kryesuesues, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Ilmi Azemi (anëtar më i vjetër i KPF-së), i cili konstatoi se ekziston shumica e mjafueshme për punë.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – parashtroi disa pyetje: Pse nuk është sjellë rapporti i ndërmarrjes publike “Përparimi”? Në muajin prill ka qenë e planifikuar informata lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë. Pse nuk është sjellë kjo informatë nga Drejtoria për Inspektime? Çfarë po ndodhë me thirrjen publike për “Star up”? Pse nuk po publikohet lista e ngushtë lidhur me konkursin për mjek në QKMF?

Benjamin Shala, drektor i Drejtorisë për Shërbime Publike – sqaroi se raportin e ndërmarrjes publike “Përparimi” e sjell komisioni i aksionarëve dhe në momentin që përgatitet do ta sjellim në seancë.

Ergin Sunguri, drektor i Drejtorsë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – lidhur me thirrjen publike për “Start up”, ai sqaroi se është në procedurë dhe se komisioni është duke punuar.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se përmes postës elektronike ka ardhur një pikë shtesë “Informatë lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022”. Ai propozoi që të futet në rend të ditës.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12.4.2023;
- Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve për “Ditën e Çlirimt”;

3. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë;
 4. Shqyrtimi i kërkesës për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për nevojat e Spitalit të Përgjithshëm “Sheikh Zayed” në Vushtri;
 5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrisë për vitin 2022;
 6. Të ndryshme.
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12.4.2023.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 12.4.2023.

2. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjojheve për “Ditën e Çlirimit”.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – po më vjen keq që nuk është e pranishme drejtoresha e kulturës të na jep sqarime shtesë lidhur me propozimet për titujt “Nderi i Qytetit” dhe “Qytetar Nderi” se a është obligative që të vijnë përmes KPF-së, pasi që nuk na kanë ardhur. Kjo për shkak se nuk kam mundur ta konsultoj rregulloren e dekoratave. Prandaj, nëse dikush ka informacione për këtë do të ishte mirë të na sqaroj.

Shpëtim Zhegrova, Nënkryetar i komunës – sa i përket kësaj pike, drejtoresha e kulturës është në pushim, por sigurisht që komisioni i ka mbajtur takimet e tij dhe i ka sjell këto propozime. Ajo që kemi kërkuar nga komisioni, por edhe prej drejtoreshës ka qenë që t'i jepet hapësirës KPF-së edhe kuvendit që t'i japin propozimet e tyre, dhe se i kemi edhe katër propozime të lira dhe në këtë mënyrë t'i votojmë në mënyrë unanime. Ndërkaq, lidhur me propozimet për titujt: “Nderi i Qytetit” dhe “Qytetar Nderi” do të vijnë nga Kryetari i Komunës deri në seancë të kuvendit dhe se nuk është obligative që të vijnë në KPF.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – e përshëndes si ide që të ketë hapësirë për KPF dhe kuvend për propozime. Pasi që është një listë e gjerë e qytetarëve që kanë marrë mirënjojje, ai kërkoi që bashkë me materialin për kuvend t'ju dërgohet lista e atyre që kanë marrë mirënjojje.

Ai propozoi për mirënjojje, Rifat Shaqirin, ish – pjesëtar i UÇK-së, punëtor shëndetësor në transfuzionin e gjakut.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – besoj që Sylejmani e dha këtë propozim në emër të subjektit politik, kurse propozimet tjera subjektet politike do t'i japin në kuvend.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – sqaroi se rregullorja që e kemi propozuar në kuvend nuk lë hapësirë për propozime për mirënjojje në baza partiake, por për njerëz eminentë që kanë kontribuar dhe lidhur me këtë mund të jap propozime secili anëtar i kuvendit pa anime politike. Ai paraqiti vërejtje sa i përket propozim – vendimit, ku titujt tjerë nuk janë sjellë në KPF, pasi që rregullorja e dekoratave parashev që propozimet për titujt kryesor (“Nderi i Qytetit” dhe “Qytetar Nderi”) i jep: kryetari i komunës, çdo anëtar i KPF-së, 1/3 e anëtarëve të kuvendit dhe me 700 vota të qytetarëve. Prandaj, ne sot nuk e kemi propozimin për këta tituj dhe nuk e di a jemi në respektim të rregullores apo jo. Po ashtu,

nuk e di a është gabim teknik apo jo, por nuk ka nevojë të figurojë fjala “vërejtje” pas propozimeve. Ai kërkoi korrigjimin e propozim – vendimit.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – tha se nëse KPF-ja ka të drejtë të jep propozime për titujt “Nderi i Qytetit” dhe “Qytetar Nderi” ta dimë saktë që ta kemi mundësinë të japim propozime. Ai propozoi që të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme e KPF-së para mbledhjes së kuvendit.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – tha se te neni 11, pika 3.2, ku thuhet se <Për çdo vendim të marrë nga Kuvendi komunal, maksimum do të paguhen tri takime punuese të komisioneve respektive> Ne kemi një komision të pronave, i cili është duke punuar dhe ka mbajtur disa takime. Nëse mendohet të paguhet vetëm për tri takime, atëherë është gabim, sepse ka prona shumë dhe me vite të tëra nuk mund të kryhet verifikimi i tyre. Ai kërkoi që të futet një paragraf dhe të ceket që kompensimi për këtë komision të bëhet së paku për dy takime në muaj.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – deklaroi se si kryesues i komisionit, kam pranuar një kérkesë edhe nga Bekim Zabërgja, por konsideroj se për dy arsyen nuk mund të implementohet ky propozim. E para, komisioni e ka sjellur një raport në kuvend për Lumin e Madh. Sipas meje, me dorëzimin e këtij rapporti, puna e komisionit ka marrë fund, i ka kaluar mandati dhe se nuk ka mandat të përhershëm. Aryseja e dytë është se kostojë e kompensimit për këtë komision është në vlerën financiare prej 35 mijë euro për muajt e mbetur nëse paguhet për 3 mbledhje. Përveç bazës ligjore, unë nuk e përkrahu as në aspektin financiar.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – tha se kur është marrë vendimi, nuk është marrë vetëm për një pronë. Por, për verifikimin e të gjitha pronave të cilat janë dhënë në shfrytëzim nga viti 1999 – 2022. Ndërkaq, prona në Lumadh që të merret si prioritet është caktuar nga kuvendi dhe kryetari dhe kjo është arsyja që jemi marrë në fillim me to, ku e kemi sjellë raportin në kuvend dhe është votuar. Ai tha se mandati i këtij komisioni është deri në fund të mandatit të kuvendit.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – theksoi se nëse ceket në vendim që mandati i këtij komisioni është deri në fund të mandatit të kuvendit, unë kërkoj falje. Ju e keni dorëzuar një raport me nguti me qëllime të caktuara dhe nuk jeni marrë me shumë çështje tjera që iu ka autorizuar kuvendi.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – mos të humbim kohë për hamendje, por të vazhdojmë ashtu siç shkruhet në vendim e rregullore të kuvendit.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – tha se ka qenë propozim i imi që të themelohen këto komitete, që kemi qenë nga komunat e rralla që nuk i kemi themeluar. Është një mundësi e mirë që të profilizohen anëtarët e kuvendit në angazhimet e tyre në këto komitete në bazë të përgatitjes së tyre profesionale.

Në bazë të LVL-së dhe doracakut, parashihet që komitetet tjera t'i kenë maksimumi 6 mbledhje në vit. Pra, nëse komitetet janë të kufizuara në 6 mbledhje në vit, atëherë nuk besoj që komisionet që i themelon kuvendi mund të kenë të drejtë për kompensim për mbledhje të pakufizuar. Komisioni mund të mbajë mbledhje sa të dojë, por jemi dakorduar që të kompensohet për tri mbledhje në vit. Ashtu qysh po kërkohet që të komisioni të paguhet për dy mbledhje në muaj, atëherë bëjnë 24 mbledhje në vit, që nuk i ka as KPF-ja.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – A e ka paraparë shumën financiare për kompensim të komiteteve? Apo e ka lënë mundësinë që të bëhet sipas Ligjit të Pagave.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – theksoi se në kohën sa kemi punuar në këtë rregullore, nuk ka qenë në fuqi Ligji i Pagave. Kurse, sa u përket komisioneve, është caktuar shuma prej 50 euro, duke u thirrur në logjikën që 50 euro ka qenë edhe KPF-ja. Prandaj, këtë propozim nuk e përkrahu që të futet në rregullore që një komision i caktuar të paguhet për 2 mbledhje në muaj.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – çështja e kompensimit nuk lidhet me Ligjin e Pagave, por është në vullnetin e anëtarëve të kuvendit ta caktojnë shumën financiare. Prandaj, vlera financiare prej 50 euro për komisione është e arsyeshme, sepse bëhet fjalë për tri mbledhje në vit.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyrytar i komunës – e di që komisioni i pronave dhe ai i fshatrave e ka pasur një punë më specifike se komisionet tjera. Por, nëse ka vullnet kuvendi ta merr një vendim të veçantë për kompensim të këtij komisioni, por jo të futet në rregullore.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – tha se është mirë të ceket në rregullore që një anëtar mos të ketë të drejtë të jetë edhe në komisione tjera, por vetëm në një komision.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – ke të drejtë Agron, sepse është e cekur në rregullore që ne që jemi në KPF nuk kemi të drejtë të jemi pjesë e komiteteve tjera.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekmando:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

Ndërkaq, lidhur me çështjen e komisionit, KPF-ja rekandoi që të përgatitet një propozim – vendim për kompensim të anëtarëve të komisionit për verifikimin e procesit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale dhe të procedohet për kuvend komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i kërkesës për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për nevojat e Spitalit të Përgjithshëm “Sheikh Zayed” në Vushtrri.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyrytar i komunës – sa i përket këtij propozimi, e di që është në vullnetin e të gjithëve që t'i ipet kjo pronë spitalit. Por, duke e pasur për bazë të kaluarën ku kemi dhënë prona në shfrytëzim pa asnjë kompensim ose pa kurrfarë ndërrimi, e në anën tjetër po e shohim që komuna ka mungesë të pronave dhe nevojat janë të mëdha. Ai propozoi që mos procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, por t'i kthehet Kryetarit të Komunës për ta analizuar edhe më tutje (për shkak se komuna ka nevojë për prona), me qëllim që të takohet me Kryeministrin e Republikës së Kosovës,

ministrin e Shëndetësisë, ministren e Drejtësisë që një pjesë e pronave të AKP-së t'iu kthehen komunës ose t'i merr në shfrytëzim këto prona.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – lidhur me këtë propozim, nuk është dashur fare të vjen në KPF, pasi që siç po thoni nuk është analizuar deri në fund. Edhe unë sa kam qenë drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi, ka pasur një kërkesë të tillë dhe unë personalisht kam qenë kundër që t'i ipet spitalit në shfrytëzim, sepse QKMF-ja ka nevojë për hapësira. Prandaj, nuk kemi nevojë të ngutemi dhe të analizohet, sepse spitali ka mundësi të ndërtojë kate tjera. Ai vend është shumë strategjik dhe është nyje e sistemit shëndetësor. Prandaj, i kisha rekomanduar drejtorit të shëndetësisë që të angazhojë një ekip të ekspertëve të arkitekturës që ta bëjnë një ekspertizë se a ka qëndrueshmëri (stabilitet) ish – objekti i QKMF-së.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi:

Që të mos procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, por t'i kthehet Kryetarit të Komunës për ta analizuar edhe më tutje (për shkak se komuna ka nevojë për prona), me qëllim që të takohet me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, ministrin e Shëndetësisë, ministren e Drejtësisë që një pjesë e pronave të AKP-së t'iu kthehen komunës ose t'i merr në shfrytëzim këto prona.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën **11:20**.

Bujar Klinaku

Blllugber
Procesmbajtës

